



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në pajtim me dispozitat e nenit 16, pika 16.1, shkronja **b** dhe neni 32 pika 32.1, shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2008, merr

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01 NR. 353-1409, TË DT. 26.9.2008,**  
**LIDHUR ME CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E GJIMNAZIT TË**  
**PËRGJITHSHËM NË LAGJEN "MEDRESE - ÇAMËRIA" NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Në nenin 1 të Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Gjimnazit të Përgjithshëm në lagjen "Medrese-Çamëria" në Prishtinë, 01 nr. 353-1409, të dt. 26.9.2008, duhet të jetë:

"Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Gjimnazit të Përgjithshëm dhe shkollës fillore, të quajtur "Shkolla e Gjelbër", në lagjen "Medrese - Çamëria" në Prishtinë".

**Neni 2**

Në nenin 2 të Vendimit të cekur në nenin 1, duhet të jetë:

"Lokacioni për ndërtimin e këtyre objekteve, sipas nenit 1 të këtij Vendimi, evidencohet në fletën poseduese nr. 3838, ngastra kadastrore nr. 2129, Zona kadastrore Prishtinë, pasuri e Komunës së Prishtinës, në sipërfaqe prej 29 695 m<sup>2</sup>. Nga sipërfaqja e përmendur, 23 695 m<sup>2</sup> lokacion për Gjimnazin e Përgjithshëm, ndërsa 6 000 m<sup>2</sup> i ndahen shkollës fillore "Shkolla e Gjelbër".

**Neni 3**

Në nenin 5 të Vendimit duhet të jetë:

"Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrotjtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Pronës".

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.nr.110-1904, më 29.12.2008**

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Prof dr. Isa Mustafa**